



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:055946

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05612832

C-IV.-14-0999

Ankuesi : E E, Prishtinë.

Përfaqësuar nga Av.D R, Prishtinë.

Kundër

E paditura : Industria e Duhanit, Gjilan.

Agjencia Kosovare e Privatizimit,(AKP) Rr. “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtaren Ganimete Puka, me datë 24.04.2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZHET** kërkesa si e pa bazuar , dhe **VËRTETOHET** vendimi i AL, nr. GJI 003-0018, të datës 22.01.2024 , si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

- II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 21 shkurt 2014, i autorizuari i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Dhomën e Posaçme, kërkesë për rishikim të Vendimit nr. GJI 003-0018, të datës 22.01.2014, të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) më të cilin vendim AL-së , ia kishte refuzuar kërkesë në emër të borxhit shumë prej 3.600.57€. Parashtruesi i kërkesës pohon se vendimi i AL, është i pa bazuar sepse kreditori ka ofruar prova të mjaftueshme për ekzistimin e borxhit. Propozon që aktvendimin e AKP-së ta anulojë dhe kreditorit , t’ia miratoj kërkesës për pagesë e borxhit në shumë prej 3,600,57 €. Ne mbështetje të kërkesës se tij ka bashkangjitur këto prova: propozimin për përmbarrim të datës 16.01.2002, Vendimit AL, nr. GJI 003-0018, aktvendimin e Gjykatës së qarkut në Prishtinë E.nr.01/2002, dt.17.11.2008.

Me 18 qershor 2021, e paditura AKP-ja parashtrori mbrojtje në ankesë, ku pohoi se i kundërshton në tërësi si ekzistencën ashtu edhe lartësinë e kërkesës. Pala kundërshtare i përmbahet qëndrimit se AL-ja ka bere një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të saktë të dispozitave ligjore. Ashtu qe pretendimet e ankuesit duke i konsideruar si të papranueshme, pasi që nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL-ja në marrjen e vendimit, dhe ne këtë mënyre ka shkelur nenin 74 par 2 të Ligjit 06/L-086 i cili parasheh që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në, si dhe duke e konsideruar ankesën si të pavlefshme pasi që pas shqyrtimit të dokumenteve mbështetëse te kërkesës, AL-ja ka konstatuar se informatat e ofruara ishin të pamjaftueshme për të mundësuar përfshirjen në çfarëdo shpërndarje të te ardhurave të likuidimit. Andaj, e paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Më datë 07 korrik 2021, DHPGJS i ka dërguar të autorizuarit të ankuesit përgjigjen ndaj ankesës e parashtruar nga ana e AKP-se, mirëpo e njëjti nuk ka dhënë asnjë përgjigje lidhur me urdhrin e pranuar.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtrësive të palëve.

Arsyetimi ligjor:

Kërkesa/ Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban kërkesa/ ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”,* ndërsa pika 3 parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”.*

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata ka shqyrtuar të gjitha shkresat që gjenden në dosje të lëndës dhe pretendimet e palëve dhe ka konstatuar se kërkesa e parashtruesi të kërkesës, për kompensimin e borxhit të pretenduar, është e pa bazuar dhe u refuzua.

E paditura në vendimin e saj Vendimit nr. GJI 003-0018, të datës 22.01.2014, me të cilën ka refuzuar kërkesën e ankuesit në pjesën arsyetuese, kur i është referuara nenit 36.2. nën paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L0034, për AKP, nuk ka mohuar borxhin e pretenduar nga ankuesit , por ka arsyetuar se dokumentacioni për *kërkesën apo interesin i paraqitur nga kreditori i pretenduar mbete jo i plotë edhe pas kërkesës për dokumentet apo dëshmitë plotësues , ashtu që gjykata në një situatë të tillë konsideron se vendimi i kontestuar është i drejtë dhe ligjshëm, pasi që ankuesit edhe pranë gjykatëse ka dështuar për ti mbroj pretendimi dhe kërkime e tij , dhe kërkesa për rishikim të vendimi , në mungesë të provave-dokumentacionit që vërtetojnë një detyrim të tillë të ndërmarres”, gjë që ankuesi nuk e ka bërë, u vendos që kërkesa të refuzohet.*

Gjykata ka shqyrtuar provat e dorëzuar nga ankuesit , si propozimin për përmbarim të datës 16.01.2002, mirëpo vetëm propozimi për përmbarimi, nuk do të thotë se i jep të drejtë palës për realizim të kërkesë së pretenduar, ndërsa me aktvendimin e Gjykatës së qarkut në Prishtinë E.nr.01/2002, dt.17.11.2008, që ndërpritet procedura e ekzekutimit , mirëpo gjykata në rastin konkret , e mbron qëndrimin e AL, sepse pala ankuese kishte dështuar që ti përgjigjet AL, në shkresën e saj dt.11.06.2013, ku edhe ia kishte kërkuar dorëzimin e provave shtesë, në mbështetje të kërkesë së saj , që nënkuptim faturat nr.1011200-1 të dt.02.12.2000 dhe nr.251200-2 të dt.25.12.2000, në të cila është thirrur i autorizuari i ankuesit në mbështetje të kërkesës, prandaj vendimi i AL konsiderohet si i drejtë dhe i ligjshëm. Ankuesi edhe me kërkesë/ ankesë para gjykatës nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se e paditura, i ka mbetur borxh shumë e pretenduar në kërkesë, për çka edhe kërkesa u refuzua.

Përfundimisht gjykata ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret vendimi i atakuar, nga pala kundërshtare është i drejtë kur ka vepruar dhe ka zbatuar drejtë dispozitën ligjore të cituar me lartë dhe gjykata bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme në çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit , vendosi si në dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi ka paguar taksës gjyqësore .

Këshilla juridike Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r e

Ganimete Puka